

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga shoqëritë Hajneman Afrika GmbH me seli të regjistruar në Koreashtrase 3, 20457 Hamburg, Gjermani, Xhordanijan Djuti Fri Shops me seli të regjistruar në Kompleksin Amon, pranë Hotelin Central Park, Tunizi St. 941601, Aman, 11194, Jordan dhe Arab Suplaj & Trejding Ko. me seli të regjistruar në 6340 Al Ahsa 3108 Al Zahra Dist. Riad 12812, Mbretëria e Arabisë Saudite, e dorëzuar përmes avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 26.02.2024, miratoi

### AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Hajneman Afrika GmbH me seli të regjistruar në Koreashtrase 3, 20457 Hamburg, Gjermani, Xhordanijan Djuti Fri Shops me seli të regjistruar në Kompleksin Amon, pranë Hotelin Central Park, Tunizi St. 941601, Aman, 11194, Jordan dhe Arab Suplaj & Trejding Ko. me seli të regjistruar në 6340 Al Ahsa 3108 Al Zahra Dist. Riad 12812, Mbretëria e Arabisë Saudite, do të formojë një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2.Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

## Arsyetim

Në përputhje të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 22.01.2024, dhe i plotësuar më 26.01.2024, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga shoqëritë Hajneman Afrika GmbH me seli të regjistruar në Koreashtrase 3, 20457 Hamburg, Gjermani, Xhordanijan Djuti Fri Shops me seli të regjistruar në Kompleksin Amon, pranë Hotelin Central Park, Tunizi St. 941601, Aman, 11194, Jordani dhe Arab Suplaj & Trejding Ko. me seli të regjistruar në 6340 Al Ahsa 3108 Al Zahra Dist. Riad 12812, Mbretëria e Arabisë Saudite, me të cilat shoqëritë Hajneman Afrika GmbH, Xhordanijan Djuti Fri Shops dhe Arab Suplaj & Trejding Ko. do të formojnë një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota e cila ende nuk është krijuar për të ofruar shërbime të shitjes me pakicë pa doganë gjatë udhëtimit dhe për të menaxhuar dyqane të tilla.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

- **Hajneman Afrika GmbH** është një shoqëri e varur e Gerb. Hajneman SE Ko. KG, (GH). GH është një biznes familjar që menaxhon dhe furnizon dyqane djuti fri/ dyqane me vlerë gjatë udhëtimit në aeroporte, porte detare, tragete, anije turistike dhe pika kufitare në mbarë botën.

GH ka një shoqëri të varur/grupore në Maqedoninë e Veriut - Shoqëria për Tregti dhe Shërbime TRAVEL FRI MA SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rr. Maqedonia nr. 5-2/22 Shkup dhe aktiviteti prioritar i regjistruar - tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, kryesisht me ushqime, pije dhe duhan.

- **Xhordanijan Djuti Fri Shops** është një shoqëri aksionare publike, e themeluar sipas ligjeve të Jordanisë. Xhordanijan Djuti Fri Shops merret me themelimin, menaxhimin dhe investimin në dyqane djuti fri në pikat kufitare dhe në çdo zonë në të cilën autoritetet lejojnë. Gjithashtu shet mallra të huaja dhe vendase të importuara në valutë të huaj dhe vendase në dyqane djuti fri. Asnjë nga dy dyqanet djuti fri me të cilët operon Xhordanijan Djuti Fri Shops XHDFSH nuk ndodhet në aeroportet e Jordanisë.

Xhordanijan Djuti Fri Shops XXX<sup>1</sup>, pa asnjë subjekt të regjistruar në Maqedoninë e Veriut dhe pa të ardhura të krijuara në Maqedoninë e Veriut në 2022.

---

<sup>1</sup> Të dhënat përbëjnë fshehtësi afariste

**-Arab Suplaj & Trejding Ko.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe e njëjta merret me punimet e përgjithshme të ndërtimit të objekteve banesore dhe jo banesore, rrugëve, rrugicave, pranë termocentraleve dhe konvertuesve. Nëpërmjet shoqërive të varura nën kontroll, Arab Suplaj & Trejding Ko. Grupi është aktiv në bujqësi, prodhimin e ushqimit, tregtinë me pakicë dhe shumicë, transportin, kujdesin shëndetësor, ndërtimin, komunikimin, strukturat e çelikut dhe materialet e ndërtimit, polimeret, farmaceutikët, plehrat, aktivitetet e pasurive të paluajtshme, investimet, strukturat e çelikut dhe materialet e ndërtimit. Arab Suplaj & Trejding Ko. nuk merret me ofrimin e shërbimeve të shitjes me pakicë gjatë udhëtimit në aeroporte në Vendndodhjet e Udhëtimit.

Arab Suplaj & Trejding Ko. Grupi nuk është aktiv në Maqedoninë e Veriut, gjegjësisht nuk ka shoqëri të varura që nuk kanë realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022.

Synimi i pjesëmarrësve në përqendrim është që sipërmarrja e përbashkët OpKo të jetë aktive në ofrimin e shërbimeve dhe shitjet me pakicë gjatë udhëtimeve pa taksa në Aeroportin Ndërkombëtar King Abdulaziz në Xhedë, Mbretëria e Arabisë Saudite . XXX<sup>2</sup>.

Asnjë sipërmarrje e përbashkët nuk është planifikuar që OpKo të jetë e pranishme në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

## **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS**

**KRYETARE**

**Ана Николоска**